



Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën në Qytetin e Nju-Jorkut (NYC Office of Child Support Services) Programi i suksesit të prindërve (Parent Success Program): Punësimi Pyetjet e shpeshta (FAQ)

Për prindërit që i kanë borxh detyrimin e përhershëm të mbështetjes financiare për fëmijën Departamentit të Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut (New York City Department of Social Services, NYC DSS), Programi i Suksesit të Prindërve i Zyrës së Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut mund t'ju ndihmojë të reduktoni këtë borxh me deri në \$7,500 duke kryer një program të kualifikuar për trajtimin e varësisë nga droga ose të shërbimeve për punësim.

Përse po e ofrojmë këtë program? Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (Office of Child Support Services, OCSS) e kupton që shumat e mëdha të borxhit mund ta bëjnë të vështirë që prindërit të përmirësojnë jetën e tyre dhe të mbështesin financiarisht fëmijët.

Jeni duke u rikuperuar nga varësia ndaj drogës? Mësoni se si kryerja e një programi për trajtimin e varësisë nga droga mund t'ju ndihmojë më tej për reduktimin e borxhit ndaj DSS-së. Referojuni fletushkës **“Programi i suksesit të prindërve: Pyetjet e shpeshta për trajtimin e varësisë nga droga”** për më shumë detaje.

Si ta zbuloj nëse kam detyrim të përhershëm të mbështetjes financiare për fëmijën?

Programi i Suksesit të Prindërve mund të zvogëlojë detyrimin e përhershëm të caktuar që i detyroheni DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut, gjë që ndodh kur mbështetja financiare për fëmijën nuk paguhet plotësisht ndërsa fëmija juaj merr përfitime të ndihmës ekonomike. Për të zbuluar nëse i detyroheni Departamentit të Shërbimeve Sociale të qytetit të Nju-Jorkut:

- Vizitoni qendrën fizike të shërbimit të klientit të Zyrës së HRA-së të Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS), planifikoni një takim virtual ose shkoni në një zyrë të OCSS-së në Gjykatën e Çështjeve Familjare. Kërkoni shqyrtimin e çështjes suaj me një punonjës social të mbështetjes financiare për fëmijën. Për më shumë informacione, shkoni te <https://on.nyc.gov/contactocss>; ose
- Pyesni programin tuaj të punësimit nëse kanë Child Support Snapshot. Nëse kanë, mund t'i jepni leje që të shikojë çështjen tuaj të mbështetjes financiare për fëmijën. Ata mund t'ju tregojnë nëse keni detyrime ndaj DSS-së si edhe shumën që i detyroheni. Borxhi i DSS-së që i detyrohet një qarku ose shteti tjetër nuk përfshihet në këtë program.

Çfarë duhet të bëj?

Duhet të merrni pjesë në një program të kualifikuar punësimi të DSS-së si p.sh. Programi i Mbështetjes së Prindërve, Jobs-Plus ose një program partner i kualifikuar i trajnimit për punë i OCSS-së. Programet e kualifikuara të punësimit të DSS-së gjithashtu përfshijnë ato që mund t'ju referohen nga Ndihma Ekonomike ose Programi për Ndihmën Ushqimore Suplementare (Supplemental Nutrition Assistance Program, SNAP).

Pasi jeni regjistruar në një program të kualifikuar punësimi të DSS-së, duhet të gjeni një punë dhe ta raportoni këtë në programin tuaj të punësimit. Më pas, punëdhënësi juaj duhet të paguajë mbështetjen tuaj financiare për fëmijën për të paktën 90 ditë përmes një Urdhri për Mbajtjen e të Ardhurave (Income Withholding Order, IWO). IWO-ja do t'i komunikojë punëdhënësit tuaj se sa para të mbajë nga paga juaj për mbështetjen financiare për fëmijën. Punonjësi do t'i dërgojë para OCSS-së.

A duhet të dërgoj vërtetim që punëdhënësi im ka bërë pagesa të IWO-së në emrin tim?

Jo. Nuk është e nevojshme të dërgoni vërtetim që punëdhënësi juaj ka bërë pagesa të IWO-së. OCSS-ja mban një regjistrim të pagesave që ne marrim nga punëdhënësi juaj.

Pas sa kohësh pasi të bëj pagesa të mbështetjes financiare për fëmijën për 90 ditë do të reduktohet detyrimi im?

Kjo mund të kërkojë deri në tetë (8) javë. Pasi ofruesi juaj i punësimit i raporton punën tuaj OCSS-së, OCSS-ja do të shikojë nëse keni detyrime të prapambetura ndaj DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut dhe nëse ne kemi marrë pagesat nga punëdhënësi juaj për të paktën 90 ditë. Pasi të kualifikoheni, OCSS-ja do të heqë deri në \$7,500 të detyrimeve të prapambetura të DSS-së nga llogaria juaj e mbështetjes financiare për fëmijën. Ne do t'ju dërgojmë me postë një letër ku konfirmohet shuma me të cilën është reduktuar borxhi që i detyroheni DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut.

Ndërsa jam i regjistruar në një program punësimi, a mund të ketë veprime të ekzekutimit të detyrueshëm kundër meje për mospagesën e mbështetjes financiare për fëmijën?

Po. Të gjitha veprimet e ekzekutimit të detyrueshëm do të vazhdojnë.

A duhet të detyrohem \$7,500 ose më shumë?

Jo, nuk është e nevojshme të detyroheni \$7,500. OCSS-ja do të reduktojë shumën e detyrimit tuaj ndaj DSS-së deri në \$7,500.

A mund të regjistrohem në Programin e Suksestit të Prindërve më shumë se një herë?

Po, mund të regjistroheni më shumë se një herë. Nëse keni me shumë detyrime ndaj DSS-së dhe siguron një punë të re pas regjistrimit sërisht me një program të kualifikuar punësimi të DSS-së, mund të kualifikoheni gjithashtu për një reduktim tjetër. Sidoqoftë, shuma maksimale totale e borxhit që mund të reduktohet për pjesëmarrje në një program të kualifikuar punësimi të DSS-së është \$7,500.

Nëse paguaj mbështetje financiare për fëmijën, a mund të kem të drejta vizite?

Në qytetin e Nju-Jorkut, vendimet për urdhrat e mbështetjes financiare për fëmijën dhe të drejtat për vizitë i vendosin dy gjykata të ndryshme. Nëse ju duhet informacion ose ndihmë në lidhje me të drejtat tuaja për të vizituar fëmijën tuaj, telefononi Kujdesin Ligjor për Familjen në numrin (212) 343-1122 ose vizitoni [familylegalcare.org/helpline](https://on.nyc.gov/familylegalcare.org/helpline).

Kam pyetje të tjera. Çfarë duhet të bëj?

Pyesni stafin e programit tuaj të punësimit të DSS-së ose programit të trajtimit të varësisë nga droga rreth Programit të Suksestit të Prindërve të OCSS-së ose kontaktoni OCSS-në me email, fizikisht ose me postë. Për më shumë informacion, shkoni te <https://on.nyc.gov/contactocss>.

A keni ndonjë problem shëndetësor ose problem të shëndetit mendor apo aftësi të kufizuara? A e keni të vështirë që për shkak të këtij problemi të kuptoni atë çfarë thuhet në njoftim apo të bëni atë që ju kërkohet? A jua vështirëson kjo gjendje përfitimin e shërbimeve të tjera në HRA? **Ne mund t'ju ndihmojmë.** Na telefononi në numrin **718-557-1399**. Gjithashtu, ju mund të kërkon ndihmë duke u paraqitur pranë një zyre të HRA-së. Ju gëzoni të drejtën ta kërkonit këtë lloj ndihme në përputhje me ligjin.